



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Metodologji e Përkthimit

Ngarkesa: 3 Kredite - (= 60 orë mësimore); Leksione: 3 Kredite - (= 30 orë mësimore);
Seminare: 30 Kredite - (= 30 orë mësimore);
Viti / Semestri: Viti I, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master Profesional, Përkthim me profil përkthyes
Kodi i etikës: Kodi i etikës, Universiteti i Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të nxisë zhvillimin e mendimit kritik dhe të aftësive kërkimore në fushën e përkthimit. Të orientojë studentët drejt përdorimit të mjeteve teorike dhe metodologjike në analizën e përkthimit. Të ndërgjegjësojë studentët për rëndësinë e kërkimit shkencor dhe aplikimit të tij në praktikën përkthimore.

Objektivat specifike lëndore:

1. T'u mësojë studentëve si të identifikojnë problematikat konkrete në përkthim dhe t'i lidhin ato me strategji kërkimore.
2. T'i udhëzojë për dallimin midis kërkimit konceptual dhe atij empirik në fushën e përkthimit.
3. T'i pajisë me njohuritë dhe format e shkrimit të eseve kërkimore, kumtesave dhe mikrotezës.

Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studentët do jenë të aftë të:

1. Ndërgjegjësohen mëtej në lidhje me dallimet gjuhësore dhe kulturore;
2. Ndërgjegjësohen mëtej në lidhje me funksionet specifike të llojeve të ndryshme tekstore nën kontekste të shumëllojshme komunikimi;
3. Reagojnë në mënyrë kritike dhe të pavarur ndaj materialeve të caktuara për detyra përkthimore;
4. Kuptojnë tërë aspektet e një game të gjerë konceptesh gjuhësorë dhe terminologjisë;